ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208 Udheheqesi-24-5119-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Avancimi dhe ridizajnimi i SMIA – s**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**"LOGISTICS PLUS"L.L.C.**
NUI	**600101472**
Adresa	**Rr. Rexhep Krasniqi nr.5**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**-10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Edi Bunjaku**
Adresa elektronike	**vprelvukaj@logisticsplus-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.07.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Avancimi dhe ridizajnimi i SMIA – s

Njoftim për Kontratë: 25.05.2024

Afati i fundit për dorëzim te ofertave: 05.07.2024

Kerkesa per rishqyrtim: 25.06.2024

Vendimi ne kerkese per rishqyrtim: 27.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesa per rishqyrtim, date: 25.06.2024

Vendimi ne kerkese per rishqyrtim, date: 27.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 7
- Neni 51.3
- Neni 52.3
- Neni 4.3.c - RRPP
- Opinioni Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023)
- Neni 69.1

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues, me kërkesat për listën e të punësuarve, duke përfshirë kualifikimet profesionale të stafit kryesor, ka shkelur:

1. AK me kërkesat për listën e të punësuarve (Menaxheri i Projektit, Drejtuesi i Ekipit Teknik, Menaxheri i Sigurisë Kibernitike, Menaxheri i Mbështetjes së TI-së, Zhvilluesi i Software, Specialisti i Bazës së të Dhënave, Shërbimet e Uebit dhe Zhvilluesi i API-ve të Uebit) ka shkelur nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, ashtu që ka favorizuar një Operator Ekonomik ndaj të cilit ka përshtatur kërkesat për stafi siç janë: diplomimet, certifikatat dhe përvoja e punës së stafit. Të gjitha këto, specifika që i përshtaten një OE të caktuar.

Neni 7 i LPP-së specifikon si në vijim: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik."

2. AK, duke vendosur pozita që nuk janë as drejtpërsëdrejti relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës, shkelë paragrafin 3 të nenit 51. I njëjti specifikon si në vijim: Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse."
Paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik duke vendosur pozita që nuk jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës, por i janë përshtatur stafit që kompania e favorizuar i posedon. Në paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, thuhet "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë

drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse."

3. AK ka shkelur nenin 52.3 të LPP-së sepse ka vendosur kritere të pa matshme për vlerësim në Dosje të Tenderit, dhe kritere që nuk janë relevante me lëndën e kontratës. Kjo dispozitë ligjore specifikon si në vijim: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla mund të jenë në lidhje me p.sh., cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike"

4. Tek Dëshmitë për Menaxherin e Projektit, konkretisht dëshmia "Zbatimi i të paktën 3 projekteve të suksesshme për sistemet e menaxhimit të informacionit, nga të cilat një referencë e suksesshme në sistemet e informacionit arsimor të shkallës së ngjashme, si menaxher projekti", AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit nr. 1731/23 dt. 19/09/2023. Agjencia përmes këtij Opinioni specifikon se është e kundërligjshme nga AK që të bëj kufizimin e numrit të projekteve për Menaxherin e Projektit, sepse në këtë mënyrë dëmtohet konkurrenca e lirë dhe kufizohet, ndërsa në anën tjetër OE-të tjera diskriminohen kur ka këso lloj kërkesash.

5. AK ka kërkuar për Menaxherin e Projektit këto kualifikime si në vijim:
- Diplomë universitare (ekuivalente me 240 ECTS) Master në shkenca kompjuterike ose Master në inxhinieri kompjuterike ose Diplomuar në kompjuter dhe telekomunikacion
- Të ketë - PMP – Profesionist i Menaxhimit të Projektit, certifikatë e vërtetuar e vlefshme në PMP dhe Njohuri të gjuhës angleze

NDËRSA, si dëshmi për këto kërkesa, ka kërkuar dokmentacionin si në vijim:
- Minimumi 10 vjet eksperiencë në punë në menaxhimin e projekteve (e vërtetuar me kontratë pune ose të dhëna pune ose letër konfirmimi të punësimit) – (në Dosjen e Tenderit të datës 03/07/2024 kriterin e eksperiencës e ka ulur në 5 vite)
- Zbatimi i të paktën 3 projekteve të suksesshme për sistemet e menaxhimit të informacionit, nga të cilat një referencë e suksesshme në sistemet e informacionit arsimor të shkallës së ngjashme, si menaxher projekti
- Deklaratë nga Propozuesi për caktimin e menaxherit të projektit
- Përvoja në krijimin e planeve të projektit, paneleve, statistikave dhe raporteve të statusit
- Aftësi për të komunikuar qartë me një sërë palësh të interesuara
- Përvojë në mjedisin teknik të mëposhtëm – Modelet e Dizajnit, Uebi i Përgjithshëm RESTful dhe SOAP, Kuptimi i Shërbimit dhe arkitektura SOA
- Aftësi të shkëlqyera prezantuese dhe komunikuese

Këto kërkesa, bien kryekëput në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 1 SEPSE NUK JANË FARE DËSHMI të kualifikimeve të përcaktuara më lart.

6. AK ka kërkuar për Drejtuesin e Ekipit Teknik Arkitekt i Sistemit këto dëshmi si në vijim:
- Përvojë e dëshmuar si Dizajn i Arkitekturës së Sistemit për të paktën 8 vjet (në dosjen e re të tenderit të datës 03/07/2024, përvojën 8 vjeçare AK e ka ndërruar me 5 vite), në të

paktën tre (3) projekte të një natyre të ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe SOA arkitekturës".

Duke vepruar kështu në kundërshtim me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023), ku sipas atij opinioni, ky Agjencion, brenda mandatit dhe kompetencave të veta, ka deklaruar se është e kundërligjshme dhe se AK nuk ka të drejtë që të bëj kufizimin e numrit të projekteve. Pra, sipas Agjencisë e cila ka mandat ligjor që të parandaloj korrupsionin, konkurrenca e lirë dëmtohet, kufizohet ndërsa në anën tjetër OE tjerë diskriminohen në rastet kur AK-të paraqesin këso lloj kërkesa.

Për këtë pozitë, AK ka kërkuar kualifikimet po ashtu:
- Diplomë universitare (ekuivalente me 240 ECTS) Master në shkenca kompjuterike ose Master në inxhinieri kompjuterike ose Diplomuar në kompjuter dhe telekomunikacion
- Njohuri të gjuhës angleze

Ndërsa, si dëshmi për këto kërkesa ka kërkuar dokumentacionin si në vijim:
- Minimumi 8 vjet përvojë (në dosjen e re të tenderit të datës 03/07/2024, përvojën 8 vjeçare AK e ka ndërruar me 5 vite) në projekte IT për projektimin dhe zhvillimin e sistemeve softuerike (e vërtetuar nga kontrata e punës ose të dhënat e punësimit ose letra e konfirmimit të punësimit) – (në Dosjen e Tenderit të datës 03/07/2024 kriterin e përvojës e ka ulur në 5 vite)
- Përvojë e dëshmuar si Dizajn i Arkitekturës së Sistemit për të paktën 8 vjet në të paktën tre (3) projekte të një natyre të ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe SOA arkitekturës
- Përvojë në menaxhimin e bazës së të dhënave dhe të meta të dhënave
- Përvojë në zhvillimin e Shërbimeve Ueb
- Njohuri gjithëpërfshirëse në metodat dhe teknologjitë moderne për zhvillimin e projekteve të TI-së

Këto kërkesa, bien kryekëput në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 1 SEPSE NUK JANË FARE DËSHMI të kualifikimeve të përcaktuara më lart.

7. AK ka kërkuar Menaxherin e Sigurisë Kibernitike, këto kualifikime si në vijim:
- Minimumi 5 vjet eksperiencë në projekte IT për kontrollin e Rrjetit dhe Sigurisë IT (e vërtetuar nga kontrata e punës ose të dhënat e punësimit ose letra e konfirmimit të punësimit)
- Përvojë në Dizajnimin dhe Testimin e zgjidhjeve të reja IT nga aspekti i sigurisë
- Përvojë në testimin e penetrimit dhe vlerësimet e cenueshmërisë
- Përvojë në analizën e malware dhe zhvillimin e teknikave mbrojtëse nga sulmet e sofistikuara kibernetike
- Të zotërojë certifikatat e mëposhtme ose ekuivalentet e tyre
- Certifikatë në "Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe Informacionit".
- Certifikatë në Malware Reverse Engineering dhe
- Certifikatë në IPv6 siguri

Këto kërkesa, përveç që janë në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 1 SEPSE nuk janë fare dëshmi të kualifikimeve të kërkuara në DT, e të cilat janë:
- Diplomë universitare (ekuivalente me 180 ECTS) Bachelor në Shkenca Kompjuterike

ose Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
- Njohuri të gjuhës angleze
Të njëjtat PO ASHTU janë edhe në kundërshtim me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023), ku sipas atij opinioni, ky Agjencion, brenda mandatit dhe kompetencave të veta, ka deklaruar se është e kundërligjshme dhe se AK nuk ka të drejtë që të bëj kufizimin e numrit të projekteve. Pra, sipas Agjencisë e cila ka mandat ligjor që të parandaloj korrupsionin, konkurrenca e lirë dëmtohet, kufizohet ndërsa në anën tjetër OE tjerë diskriminohen në rastet kur AK-të paraqesin këso lloj kërkesa.

8. AK për pozitën Menaxher të Mbështetjes së TI-së, ka kërkuar këto kualifikime:
- duhet të ketë Diplomë universitare (ekuivalente me 180 ECTS) Bachelor në Shkenca Kompjuterike ose Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, Certifikata e themelimit ITIL 4 për Menaxhimin e Shërbimit, OSE CERTIFIKATA EKUIVALENTE (pjesën e certifikatës ekuivalente AK e ka shtuar në Dosjen e Tenderit të datës 03/07/2024)
- Njohuri të gjuhës angleze
NDËRSA, për këto kualifikime ka kërkuar dëshmitë si në vijim:
- Minimumi 3 vjet përvojë në menaxhimin e mbështetjes së IT (e vërtetuar nga kontrata e punës ose të dhënat e punësimit ose letra e konfirmimit të punësimit)
- Përvojë në mbështetje të klientëve duke ofruar udhëzime të vlefshme rreth operacioneve
- Përvojë në optimizimin e infrastrukturës së TI-së me llogaridhënie për cilësinë e shërbimit të ofruar
- Përvojë në mbështetjen në distancë të përdoruesve fundorë
- Përvojë në sigurimin e shërbimit në kohë dhe të saktë për përdoruesit fundorë
- Përvojë në vendosjen e standardeve specifike të shërbimit të përdoruesit fundor
- Përvojë në përmirësimin e mbështetjes së TI-së duke monitoruar në mënyrë aktive dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të përdoruesit fundor
- Përvojë në krijimin e praktikave më të mira gjatë gjithë procesit të mbështetjes teknike
Këto kërkesa bien në kundërshtim të plotë me paragrafin 1 të nenit 69, ashtu që as për së afërmi nuk janë dëshmi të kualifikimeve të kërkuara për këtë staf.

9. AK për pozitën Zhvillues Softueri ka kërkuar dëshmi si në vijim:
- Të ketë marrë pjesë në zhvillimin e softuerit për të paktën pesë (5) vjet në të paktën tre (3) projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), të ketë qenë zhvillues softuerësh për të paktën një (1) projekt i një natyre të ngjashme i zhvilluar në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe arkitekturën SOA.
Kjo kërkesë është në kundërshtim Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023), ku sipas atij opinioni, ky Agjencion, brenda mandatit dhe kompetencave të veta, ka deklaruar se është e kundërligjshme dhe se AK nuk ka të drejtë që të bëj kufizimin e numrit të projekteve. Pra, sipas Agjencisë e cila ka mandat ligjor që të parandaloj korrupsionin, konkurrenca e lirë dëmtohet, kufizohet ndërsa në anën tjetër OE tjerë diskriminohen në rastet kur AK-të paraqesin këso lloj kërkesa.

Po ashtu, për të njëjtën pozitë ka kërkuar kualifikimet si më poshtë:
- Diplomë universitare (ekuivalente me 180 ECTS) Bachelor në Shkenca Kompjuterike

ose Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike,
- Certifikuar në Microsoft Certified Professional,
- Njohuri të gjuhës angleze
NDËRSA dëshmitë për këto kualifikime janë këto si më poshtë:
- Përvojë e dëshmuar të paktën pesë (5) vjet në zhvillimin e softuerit në platformën Microsoft (.Net me SQL Server), zhvillimin e projekteve të natyrës së ngjashme.
- Të ketë marrë pjesë në zhvillimin e softuerit për të paktën pesë (5) vjet në të paktën tre (3) projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), të ketë qenë zhvillues softuerësh për të paktën një (1) projekt i një natyre të ngjashme i zhvilluar në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe arkitekturën SOA.
- Përvojë e demonstrueshme në ndërlidhjen me klientët në nxjerrjen e rasteve të përdorimit dhe nxjerrjen e kërkesave.
- Përvojë pune në cikle të ndryshme të zhvillimit të softuerit
Të gjitha këto bien në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 69 sepse as për së afërmi NUK JANË dëshmi të kualifikimeve të kërkuara për këtë staf.

Marrë parasyshë se kërkesat e stafit – qofshin atë lidhur me kufizimin e numrit të projekteve apo dëshmive të kualifikimeve të tyre, NUK PËRKOJNË ME LËNDËN E KONTRATËS DHE KUALIFIKIMET E TYRE, këto kërkesa PO ASHTU PARAQESIN SHKELJE LIGJORE TË NENIT 7, ashtu që i janë përshtatur specifikisht ndonjërit prej Operatorit tjetër Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë.

AK, po ashtu edhe pse kishte refuzuar kërkesat për rishqyrtim të të gjithë operatorëve të pakënqaur, më datë 03/07/2024 sjellë Dosjen e re të Tenderit, ku të vetmet ndryshime janë se:
- tek Menaxheri i Mbështetjes së TI-së, ka shtuar kualifikimin ‘ose qertifikata ekuivalente’
- tek Menaxheri i Projektit ka ndryshuar eksperiencën e punës nga minimum 10 vite, në minimum 5 vite
- tek Drejtuesi i Ekipit Teknik Arkitekt i Sistemit ka ndryshuar eksperiencën e punës për përvojën në projekte të IT nga minimum 8 vite, në minimum 5 vite
- tek përvoja e dëshmuar si Dizajn i Arkitekturës (për pozitën Drejtuesi i Ekipit Teknik Arkitekt i Sistemit), për përvojën e punës nga minimum 8 vite, ka ndryshuar në minimum 5 vite

Provë: Dosja e Tenderit e datës 24/05/2024 dhe Dosja e Tenderit e datës 03/07/2024

Nga sa më sipër, kërkojmë nga OSHP që:

1. Të obligoj AK qe te anuloj këtë procedurë të prokurimit ose të korrigjoj te njëjtën ne përputhje me LPP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demimi eshte min. 3,500.00 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*